

Kush po pështynë atje?

Më kujtohet se para luftës masa e çdo gjëje negative ishte maxhupi. «Mos pështyjë si maxhup!» ose «Mos shaj si maxhup!» ishin fjali të zakonshme të rrethit tim që unë i regjistroj me veshin e gjashtëvjeçarit, sa e kisha moshën në atë kohë. Çdo herë që dikush rrihej, shante, pështynë, kundërmonë e të ngjashme, shpallej maxhup. .

Por vetëm një vit më vonë maxhupi u shndërrua në çetnik që as atëherë e as sot, sinqerisht nuk ia di arsyen pse. Gjatë katër viteve të luftës me veshët e mi dëgjova fjalitë «Mos pështyjë, kështu bëjnë vetëm çetnikët!», «Mos shajë si çetnik!» dhe variacione tjera të tyre. Çdo herë kur doja të ofendoja dike, ia mveshja epitetin «çetnik». Nuk e dija kush ishin çetnikët, me çka merren, si duken, pse na qëllojnë, por e dija se ishin personazhët negativë. Më kujtohet se i quanim me përkëdhelje «Çedët». Çka e kishte shtyrë dikend që kriminelëve t'ua jep këtë emër përkëdhelës kurrë nuk do ta kuptoj. Por kjo, sidoqoftë, si edhe shumë gjëra tjera, në atë kohë për mua nuk kishte rëndësi.

Ka qenë një këngë ushtarake që e këndonim, me atë melodi që ushtarët e këndonin duke vrapuar. Nuk di si e ka titullin, sepse kurrë nuk kam qenë në ushtri, por e di se eprori e këndon i pari një strofë, pastaj të gjithë ushtarët e përsërisin atë. Kënga jonë ishte kështu: «Ne jemi Bereta jeshile, nëntëshat i bartim bile. O Karaxhiq majmuni, zbrit tani nga druni! Ja po vjen Alija, bananen ti lëpija!» Atëherë nuk dija kush ishin Beretat jeshile, e as çka është nëntëshi. E dija, kuptohet, kush ishte Karaxhiqi: tipi negativ kryesor. E dija edhe kush është Alija, por nuk e dija sa është absurde të këndoheshin ato vargje. Nuk e dija se Alija, në të vërtetë, ishte kundërshtar edhe i ushtrisë në të cilën luftonte babai im. Nuk e dinim këtë as shokët e mi, baballarët e të cilëve ishin në të njëjtën ushtri me babain tim. Por ne e këndonim këtë këngë sepse e dinim se Karaxhiqi ishte çetnik dhe meritonte emërtimin majmun. Dhe, kuptohet, e «dinim» se ai, për këtë arsye, kundërmonë, pështynë, rrihet dhe shanë.

Por, lufta mbaroj e unë po atë vit, ose ndoshta një vit më pas, dëgjova diçka që e kisha harruar për plotë katër vite. «Mos pështyjë si maxhup!» Në atë moment në mua u shfaq njëfarë nostalgjie e çuditshme. Ku kishin qenë maxhupët gjithë kësaj kohe, e pyesja veten. Pse ia patën lëshuar vendin çetnikëve? A kishin vazhduar të shanin, pështynin dhe kundërmonin? A do të na kthehen???

Kjo pyetje e fundit më mundon edhe sot. Më mundon sepse nuk dua ta pranoj përgjigjen e cila qëmoti po ravijëzohet si e vërtetë. Dhe kjo përgjigje është: po, do të kthehen. Do të kthehen madje edhe çetnikët. Do të kthehen sepse asgjë nuk kemi mësuar gjatë atyre katër viteve të mallkuara. Pothuajse asgjë nuk ka ndryshuar. Është e vërtetë se janë ekzekutuar dhe prerë në fyt me mijëra njerëz, mijëra kanë mbetur pa duar, këmbë dhe mend, mijëra janë përdhunuar, mijëra fëmijë kanë mbetur jetima. Por, të gjitha gjërat tjera janë njëjtë: nga dita në ditë njerëzit e kanë jetën më të vështirë, politikanët edhe më tej gënjejnë, në pushtet janë me vite të njejtit, dhe urrejtjen ndaj Tjetrit e has në çdo hap.

Asgjë nuk mësuam. Për më shumë edhe maxhupit ia gjetëm shokun: katundarin. Tani është katundari sinonim për të gjitha të këqijat. Dhe unë vetëm pres kur këta dy do t'ia lëshojnë prapë vendin çetnikut, ushtashit, balisë apo ndonjë të katërtit, ndoshta qifutit. Është thjesht e pabesueshme se sa e kanë të fuqishme njerëzit nevojën për të urreyer Tjetrin, duke ia mëveshur atij gjithëfarë sendesh të këqija.

Për dallim nga rrethi im, unë nuk e urrej askend. Nuk mund të urrej, thjesht nuk jam i aftë për këtë. Andaj e lus rrethin tim, të paktën atë pjesë që urrejnë, largohuni nga unë! Më shkoni në nerva dhe nuk ju duroj fare! As juve e as atë bankën e gomarit ku ju gjithnjë e vendosni Tjetrin duke ndërruar shpesh ata që i ulni aty. Unë nuk e kam një bankë të tillë dhe nuk dua ta kem. Jam më i lumtur se ju, sigurisht.

Dhjetë minuta

"Askush nuk gjuajti në ne. Askush. Unë jam në Podujevë, pra në atë rrugë, nuk u ndala, ja, as dhjetë minuta. Kjo është lufta ime, dhjetë minuta të ecjes. Gjithëçka ndodhi për dhjetë minuta. Për dhjetë minuta u ulëm në makinë. Për dhjetë minuta njërezit ma pëshurën krej luftën time. Për dhjetë minuta shkatërruan gjithçka. Për dhjetë minuta."

(Pjesëtarë i Skorpionëve)

Më ha kari për Jugosllavi. Jugosllavia ishte një ide. Unë jam nga mishi dhe gjaku. Dhe jam gjallë.

(E mbijetuara në luftën e Bosnje-Hercegovinës)

Ta qifsha unë nënën tënde. Këto janë dhjetë minutat e mia. E filloj kështu me vetëdije. Quhem Azra Çausheviq, e lindur më 1986. Ky është zëri im që nis nga dhjetë minutat tua. Për këtë rrëfim nuk vlen ajo "don't take it personal", sepse është tejet personale dhe kundër të gjithë fashistëve që therrën, që shikuan si po therren dhe që dinin se therren. Jo kafshët, po njerëzit. Dhe jo për Kërshëndjella apo Kurban Bajram, por për ide. Mu për ato dhjetë minutat tua që ta paskanë pëshurrë luftën, e mua ma shkatërruan shtëpinë deri në themel, më dëbuan me gjithë familjen time dhe e shtynë babain tim t'ua kthejë pushkën në emër timin. Për 10 minutat tua janë vlarë dhe therrë dhjetë mijë herë më shumë, madje shumë më shumë veta.

Unë mbijetova për të kërkuar ty. Ty dhe të gjithë ata që ishin me ty. Sepse ti ishe aty, e shihje dhe kishe armën, por nuk bëre asgjë me i ndal vrasjet. Ti je përgjegjës për të gjitha eshtrat që as sot nuk e dimë se ku janë. Ke mundur t'i shpëtosh me dhjetëra jetë. Ti dhe ata që shikonin me ty. Për hir të atyre eshtërave, do t'i kishe të paktën duart e pastra. Por, s'ka arsytim. Nuk dua të solidarizohem me ty. Lufta për ty ishin dhjetë minutat që i ke kaluar në një rrugë. E për dhjetë minuta, në po atë rrugë, u vranë me dhjetëra gra dhe fëmijë. Ke kaluar andej dhe je Dëshmitar, por «i pate mbyll sytë fort, fort sa s'ka më fort, për t'u bërë se asgjë nuk ke parë». Por, nuk ke llogaritur me sytë e mi, se ato do të kërkojnë ty. Ty, që i pa të gjitha dhe ishe pjesëmarrës.

Shkaku yt qëndrova në një klasë të shkollës të mbushur me ujëra të zeza, në ato banka ku uleshin deri edhe dhjetë shokë dhe shoqe, në atë bashkim-vëllazërimin tënd. Shkaku yt më kishte kapur kolla e neverisë në ora pesë të mengjesit, kur babai im gabimisht e veshi majicën time me Ros Rosakun dhe u nis në linjen e parë të frontit. Athua i ka shkuar mendja se, nëse do të vritej, kjo majicë do të më ndihmonte ta njihja. Shkaku yt unë kam jetuar si refugjate njëzet kilometra larg shtëpisë sime, sepse nuk kisha nga t'ia mbaja pas pushtimit të Bërçkos. Jetoja mu përballë varrezave dhe nuk kalonte as një ditë e vetme pa bataret për nder të të vrarëve. Shkaku yt motrën e hudha nga largpërçuesi, sepse granata fluturonte mbi kokat tona. Shkaku yt mendoja se plumbat me ndriçim janë fishekzjarret që dikush po na i çon si dhuratë dhe e ngasja bicikletën në drejtimin e tyre, për çka më patën rrahur çunat pse i hypa fare biçikletës në atë ditë. Shkaku yt i kujtoj britmat, piskamën dhe të mavijosurat në fytyrën e motrës deri sa në tre të mengjesit zbathur vraponim drejt bodrumit. Shkaku yt e vetmja lojë që e lozja si 8-vjeçare ishte ajo e luf-ta-ra-ta-ra-ta-ta. Shkaku yt si dhuratë të parë babai ma solli një ndiçues fluoroshent për minahedhësin, i rëndë 300 gramë, që e mbaja rreth qafës në vend të ikonës, kryqit të artë apo gjysmëhanës sepse i besoja babait si zotit dhe besoja se një ditë do të kthehem në shtëpinë time. Shkaku yt dhjetë vite të tëra ma kanë sharë nënën e balisë në Bërçkon multietnike që ishte një fucking district, por më thërrisnin edhe çetnikush, më pastaj edhe komuniste, sepse gjithnjë e kam thënë atë çka mendoj dhe këtë me zë të lartë që ta dëgjojnë të gjithë.

Quhem Azra Çausheviq, e lindur më 1986. Më vjen me vjell nga tregimi për Jugosllavinë por nuk bën ndryshe. Jugosllavia e viteve '80 të hershme ka qenë një alibi i elitave etno-nacionale, ku secila prej tyre e lakmonte pjesën e vetë të tortës. Këta profiterë e shitën idenë dhe fituan trefish. Etnokracinë duhet patjetër dënuar si mizogoni, gërshtim të praktikave homofobike dhe nacionaliste, të cilat edhe sot e gjithë ditën bazohen në shpërndarjen e kapitalit njerëzor, në erotizimin e kombeve dhe në praktikat e pabarazisë dhe të frikës nga Tjetri. Etnokracia sot bazohet në etnitë që kanë vdekur qëmoti, që janë artefakte, të lartësuar deri në qiell të stërshenjtë të Muhamedit, Jezusit dhe Krishtit, e bazuar në heronjë të serbë, shehitët myslimanë dhe domobranët kroat, si dhe nënat dhe gratë e tyre të shumëvujtura dhe të përdhunara. Etnokracia është mobilizim mbi premisën se populli është i padijshëm dhe nuk do të rebelohet kundër plaçkitjes së politikës liridashëse të tyre. Etnokracia do të thotë të mendosh se përdhunimi është para së gjithash një lloj këmbimi grash dhe të gjitha gjërave në

këtë botë që përfaqësojnë inferioritetin e gruas, por duke mënjanuar sulmin e dhunshëm fizik të trupit më të fuqishëm ndaj një trupi të zënë rob, dhe e gjithë kjo për hir të idealit të burrërisë dhe fallocentrizmit. Etnokracia është marrja e të drejtës që në emër të institucioneve të pohohet se eshtrat e filan njerëzve janë shehide, atëdhetare dhe domobrane, duke e zvogëluar kështu njerëzoren bazike të tyre që e kanë. Etnokracia është markim. Eshtrat janë eshtëra – janë njerëz të vdekur. Plumbat janë plumba, s'ka rëndësi çfarë dhe të kujt janë. Është vetëm një person pas plumbit, dhe një përpara. Dhe është vendimi i personit që e mban gishtin në këmbëzën e pushkës.

Unë isha peng për asfale. Për asgjë. Për ato eshtëra nën dhe. Ashtu të gjitha së bashku. Dhe dikush më ka shfrytëzuar që ato eshtëra të janë aty ku janë. E unë nuk e kisha moshën që të shkruaj, po ishte e mjaftueshme ta kujtoj se edhe babai shkonte në luftë. Ai kthehej në katër të mëngjesit nga vija e frontit dhe vetëm heshte. Dhe hesht edhe sot. E shfrytëzuan, e edhe mua me te. Andaj po të drejtohem ty. Sepse e ke mbajtur pushkën dhe ke ec në atë rrugës, një ditë prej atyre ditëve. Ndoshta ti nuk ke qitë, por ke dëgjuar, ishe aty, e pa. Dhe për këtë nuk je aspak më pak përgjegjës, më pak fajtor. Une a kam humbur fëmijërinë për shkak të dhjetë minutave tua. Ke mundur t'i shpëtosh dhjetëra jetë. Po ta kisha unë moshën e duhur, e di se unë do ta bëja këtë. Nëse si 8 vjeçare isha ne gjendje që ta pastrojë pistoletën, sot që i kam 24 vjet mund ta mbroj lirinë me trupin dhe zërin tim. Sepse, unë besoj në barazinë e të gjithë njerëzve dhe besoj se brezi im dhe unë mund të fitojmë barazinë dhe ta mbrojmë lirinë. E ti atëherë pate hequr dorë si mijëra të tjerë që me tankse u nisët drejtë shtëpisë sime. Pjesën më të rëndë ia la trashëgimi fëmijut tënd, që ta zgjedh. Merr vendimin për ose kundër barazisë, për ose kundër lirisë, - bujrum, vendos tash!

Quhem Azra Çausheviq, e lindur me 1986. Dhe këto janë dhjetë minutat e mia.

Të shikohemi me sy imagjinarë

„There is a delay in response to certain painful events that occurred in another time and place: 'For history to be a history of trauma means that it is referential precisely to the extent that it is not fully perceived as it occurs; or to put it somewhat differently, that a history can be grasped only in the very inaccessibility of its occurrence' (Caruth, 'Unclaimed Experience', p. 187). Although the victims escape apparently unharmed from an accident, they do not fully absorb what has happened to them at the time of crisis and their history acquires a traumatic compulsiveness akin to Wordsworth's uncanny vestiges of memory.”¹

Si të mendohet përvoja e luftës

Vërtetë nuk e di se si ta filloj shkrimin mbi kujtimet e mia nga lufta... S'kam haber... Por nuk jam indiferente. Gjithnjë më ka interesuar tepër shumë një çështje: Pse e kam aq vështirë të tregoj se çka ka ndodhur atëherë? A e di unë fare së çka më ka ndodhur? Në ç'masë e kuptoj, gjegjësisht nuk e kuptoj, dhe sa e përcakton kjo jetën time sot – janë disa nga pyetjet që më paraqiten. Një “bisedë” e këtillë me veten, ajo më e sinqertë, çdo herë fillon dhe përfundon vetëm me pyetje, dofarë shqyrtime filozofike, dhe rrallë herë ia arrij t'i shtrudh disa përgjigje që do të mund të ishin të paktën për afërsisht të kënaqshme. Përgjigje me të cilat do të ndihesha se mund ta rumbullaksoj më në fund atë përvojë.

Pse?

Po kjo është thjesht e tillë. Me siguri nuk është vetëm për mua kësajohit. Më e besueshme është se kjo është “natyra” e kujtimeve traumatike që gjithnjë janë fragmentare, të papërfunduara dhe enigmatike. Kujtime që nuk e kanë gjuhën me të cilën jemi mësuar të komunikojmë, por janë të shifruara ndryshe. Por tani që konstatoj se me siguri e dimë se nuk mund ta dimë, si të shkojmë përpara? Është interesante, p.sh., që për luftën mundem me artikuluat vetëm atë që e kam dëgjuar më pas, nga njerëzit tjerë ose televizioni. Në këtë mënyrë unë mësoja për luftën që edhe mua më kishte ndodhur. Si me vonesë. Dhe kur nisi e mendoj në këtë mënyrë të “mësuar” që më servirët, me gjuhën e viktimave dhe armikut, të ndasive kombëtare dhe ideologjizimeve religjioze, gjithnjë, pa përjashtim, e ndiej se është dikush tjetër që flet për mua dhe në vend timin, jo unë vetë. Kështu që qëmoti pata vendosur të pajtohem se ky tregim për realitetin tim

¹ Duncan Wu, *A Companion to Romanticism*, 1999

thjeshtë “nuk dhezë”. Nuk ka kuptim. Deri sa ende po “vendoset” se si duhet të shkruhen librat e ndryshëm për luftën, më duket se është me pak rëndësi çka mendon brezi im për gjithë këtë, pasi që në atë kohë ishim fëmijë që vështirë se kemi mundur të kemi orientim politik. As që kemi ditur për mijëra kontekste historiko-politike të nevojshme për analizën e luftës ballkanike. Kështu del se nëse nuk je i vetëdijshëm për kontekstin në të cilin rritesh, ti sikur nuk ekziston, nuk ke drejtë dhe as që mund të kesh mendim relevant. Por kjo nuk është kështu. Sepse neve na ka ndodhë lufta, dhe kemi qenë fëmijë të pa shenjësuar kombëtarisht. Andaj mendoj se është me rëndësi kyçe që të flasim mu këta “fëmijë”. Çka ka mundur të ketë tjetër një gjashtëvjeçar pos gjuhës neutrale, naivitetit dhe paanshmërisë prej fëmii. Ky është, pra, brezi im. Por, a do të thotë kjo se vetëm fëmijët kanë qasje në të vërtetën tonë?

A ekziston e vërteta puro?

Njëra nga trashëgimitë më të prekshme të mia është ndjenja e pafuqisë që më kthehet në disa momente. Është kjo ndjenje se diçka më ka ndodhur, ose po ndodh, e unë nuk kam qasje për ta kuptuar saktësisht se çka po ndodh, edhe pse është rrënjësor ose po rrënjësohet në çdo pore të jetës sime. Ngjan sikur nuk mund të lëvizni në ëndërr. Unë kam bindjen se jam në gjendje që ti përcjelli rregullisht sulmet e këtyre “gjendjeve” që më përshkojnë dhe sigurisht edhe ndikojnë në përditshmërinë time në mënyra të panjohura për mua. Më ka shkuar mendja se ndjenje të ngjashme kanë pasur edhe disa zonja angleze të kohës Viktoriane, të cilave jeta nuk ua ka ofruar më shumë se shtëpinë, burrin, fëmijët, garderobën e tyre dhe, kuptohet, makiazhin. Por çka ndodh me ato që gjithnjë tregohen të pakënaqura por nuk dinë se çka kanë – dhe për më shumë nuk shohin rrugëdaljen sepse në “parim” i kanë pas të gjitha për çka kanë pas nevojë. Kjo ndjenje e pafuqisë do të duhej të artikulohej si nevojë e natyrshme ashtu sikur që është e natyrshme të kesh etje. Etje për liri. Fëmii që në luftë nuk ka asnjë mundësi që të luftojë për veten, instiktivisht ndien rrezikun e gjendjes së tij, dhe pos frikës, ndien se është edhe i pashpresë, sepse nuk e di gjuhën me të cilën mund të reagojë ndaj absurditetit të luftës. Fëmijët janë të privuar nga çdo lloj participimit në atë çka po i ndodhë. Kjo është një padrejtësi në nivelin fizik, psikik por edhe në një nivel interesant lingustik.

Para pak kohësh jam shoqëruar me një vajzë të brezit tim që është rritur në Beograd, por që si unë momentalisht nuk jeton në Ballkan. Sapo u njoftuam në bisedë na është imponuar tema e luftës dhe të dyjat e vazhduam pa qejf, duke ditur se sipas rregullave që i ka vendosur brezi i prindërve tanë do të duhej të shikoheshim si armiq. Megjithatë, arritëm ta vazhdojmë bisedën sepse ajo mbeti në rrafshin personal – rrafshin e përvojave tona, kështu që shmangem zhargonin politik që me gjasa do ta ndërpriste temën, ose do ta shndërronte në grindje. Tregimi i saj, i rrëfyer pa korniza politike dhe shablona të ngjashëm, ishte shumë i ngjashëm me rrëfimin tim. Ndihesha e kënaqur pas kësaj, sepse kjo bisedë e suksesshme më dukej si një

triumf personal, si fitore e saj dhe e imja mbi politikat që na detyrojnë të ndahemi në tarafe dhe bëhen përcaktuese për jetët tona.

Kam menduar dhe do të vazhdoj të mendoj se cila është mënyra më e mirë dhe më pozitive e të menduarit mbi përvojën tonë ballkanike, sipas mundësive e çliruar nga politikat dominuese. Ndonjëherë më ndihmon paramendimi se mu në atë çast unë po vëzhgohem nga një “fëmijë imagjinar” i cili ka po aq vjet sa i kam pas unë atëherë, në vitet e nëntëdhjeta. Dhe se, ah, mu këtij fëmiju imagjinar duhet t’ia shpjeg se çka është duke ndodhur.

Në fillim dashuria, në jetë urrejtja, në fund kujtesa

Kujtoj si sot shokët e mi të paraluftës dhe veten se si vraponim zbathur nëpër makadamin e pluhurosur para ndërtesës. Kushedi se sa shumë herë kemi ndërtuar kullat nga zalli, gatuar kulaçet nga balta, luajtur kukafshehtas, me toptha, kocka, lojën e shkollës, me lastikë, këndonim së bashku ca këngë për fëmijë të dashura dhe të hareshme. E kujtoj edhe axha Simbadin. Sa e sa herë na mashtronte me shakatë e tija pa sherr: “Ja helikopteri është lëshuar lartë tek rruga dhe po ua hedh fëmijëve çokollata dhe bombona.” Sa shpejtë vraponim, duke u mbajtur të gjithë për dore, drejt helikopterit të cilin asnjëherë nuk e gjenim aty.

E kujtoj edhe shpjegimin e babit pasi që dëgjuam krismën e parë dhe jehonën e granatës në largësi, dhe pas asaj u aktivizua edhe sirena e alarmit nga fabrika e krypës përballë shtëpisë sonë: «Mos ki frikë. Janë grindur pak atje disa njerëz të rëndësishëm», tha ai. «Por axha është atje në anën tjetër dhe ai e di ku jemi, nuk do të qëlloj me granata ndërtesën tonë». Shokët e mi të luftës dhe unë vazhduam të vraponim por me kujdes dhe frikë, dhe sa herë që dëgjonim atë krismën e granatës së lançuar në largësi dhe sirenën e alarmit pas kësaj, me shpejtësi vraponim drejt strehimores më të afërt. Lojrat tona të dikurshme kukafshehtas u bënë realitet i yni i përditshëm në strehimoret. Klikerët i zëvendësuam me saçmat ende të ngrohtë që i gjenim pas dalljes nga strehimorja. Kullat tona nga zalli çdo ditë i shkatërronin ata njerëz të rëndësishëm që ishin grindur pak mes veti. Kur një ditë e nxorra një copëz të granatës nga dera e banesës sonë i thash babit se këta njerëz të rëndësishëm qenkan vërtet të këqij dhe se axha ndoshta e paska harruar ku gjendet ndërtesa e jonë. Në mbramje na lajmëruan se axha, që atëherë ishte 19 vjeç, kishte vdek.

Axha Simbadi nuk bënte më shaka me ne. Më pat thënë një ditë se është shumë i pikëlluar sepse gruaja e tij, Nada, kishte ikur me fëmijët në «anën e dushmanëve» dhe se ai nuk ka mundur të shkojë sepse ajo është serbe, e ai mysliman... Atëherë i pata dëgjuar për herë të parë këto dy fjalë dhe nuk dija se çfarë është kuptimi i tyre,

por edhe nuk e kisha me rëndësi... Po dikush si duket e kishte me rëndësi... Babin tim të gjithë e thërrisnin Malazez. E dija kuptimin e kësaj fjale. Babi është nga Mali i Zi dhe prandaj e thërrisnin ashtu. Ato ditë shpesh përmendej edhe fjala kroate, dhe kjo gjithnjë kur grindeshin babi dhe mami, andaj supozoja se është diçka e keqe. E mua... mua të gjithë më thoshin 'laramane'. Edhe atëherë kjo fjalë më dukej disi qortuese. Pas kësaj fëmijëria ime u shndërrua në të qenit refugjate, pritje në radhët e gjata për paketa me ndihma të Kryqit të Kuq, në kokallat që mi mshonin kryes duke më thënë ustash ose «Artuković i vogël», e kur lufta mbaroi dhe u ktheva në vendlindje, Tuzëll, ma ngjitnin epitetin «çetnikush».

A duhet ta them dhe pastaj të mos e hap më gojën? A duhet të bëj diçka, dhe pastaj të mos bë kurrë asgjë? A duhet të hesht, i kënaqur që jam gjallë?

Koha kalonte, dhe unë u rrita... u rrita dhe gjithnjë heshtja... Heshtja për ato granata, për tophat e saçmës, strehimorën, axhën, babin, jdtën e refugjatit, kokallat, për gjithçka! Sot nuk dua të hesht, as sot e as kurrë më. Vëllazërimi dhe bashkimi i atyre «njerëzve të rëndësishëm» që «u grindën pak», është shndërruar në tortura, përdhunime, shkatërrime, vrasje, shumë varreza masive, urrejtje, dhembje dhe lotë të popullit të pafajshëm. Këtë vëllazërim-bashkim që në të vërtetë kurrë nuk ka ekzistuar, as që e dua. Unë jam këtu, e kënaqur që jam gjallë, por e zemëruar për gjithçka që ka ndodhur. Unë jam këtu dhe nuk dua të hesht më spese nuk dua që fëmijëria ime ti përsëritet dikuj tjetër.

Dijana Avdagiq

Me jakne dimri, çizme të trasha, komplet pajisje të dimërit, aterova në aeroportin e Sakramentos, kryeqytetin e Kalifornisë, që shkëqente nga dielli. Nuk i kam ende nëntëmbëdhjetë të plota e udhëtova vetëm në këtë vend që ka mbi treqindë milionë banorë. Erdha për vizitë dhe punojë në një familje amerikane. Shpejt u adaptova në mënyrën amerikane të jetës. Fillova edhe kolexhin. Vizitova shumë vende, por njerëzit këtu janë disi të çuditshëm... duken disi... më të lumtur. Nuk e kanë atë shprehjen e brengës në fytyrë, që tregon të kaluarën e dhimbshme, rropatjen me të sotmën, dhe që parandjenë edhe të ardhmën e rëndë, mbase të papërmirësueshëm. Kjo është shprehje që e shoh shpesh te shtëpia, në Bosnje. E kam parë edhe në fytyrat e prindërve të mi, posaçërisht gjatë luftës kur brenga më e madhe e tyre ishte se si të na mbrojnë dhe ushqejnë neve fëmijët, vëllaun tim më të madh, motrën dhe mua. Çka do të hanë ata vetë nuk e kishin shumë hallin sepse, siç thoshte shpesh mamaja, më e rëndësishme është të mos mbetemi unët ne, fëmijët. Pasi që kujdesesha për fëmijët në një familje amerikane, shpesh më ndodhte që ta bëja krahasimin e jetës time me jetën dy çunave amerikan që kujdesesha për ta. Duke i shikuar se si rritën pa brenga mendoja shpesh për fëmijërinë time. Nuk mund të mos u kisha zili për atë që unë nuk e kam pas kurrë. Fëmijërinë time e kam kalua nëpër strehimore. Pamja që më kujohet më së shumti është se si klam rra në gjuhë, po qaj dhe i kam mbërthyer me sa forcë kisha këmbët e babait për ta penguar që të niset në luftë. Mami qëndronte e pafuqishme pranë nesh dhe qante. E di se shpesh e unë lozja jashtë me mbesat e hoxhës që shpesh dilnin me copat e bukës të lyera me shtresë të trashë të maragrinës mbi të cilën kishin qitë shumë sheqer. Është e vërtetë se nuk i kujtoj shumë gjëra nga lufta, sepse kur ajo filloi unë kam qenë vetëm katër vjeç. E di, ose më saktë mendoj se atëherë nuk kam qenë e zemëruar, por vetëm e hutuar dhe e trishtuar. Por sot e di me siguri se ju që na patët sulmuar, ju që me 25 maj të vitit 1995 e gjuajtët grantën në Portë, vendin ku mblihdje rinia e Tuzllës, se ju nuk jeni njerëz.

Nuk jeni biles as kafshë. Atë natë keni vlarë dhjetëra vajza dhe djem të rinj, dhe prindërit e tyre i keni dënuar që të vuajnë, ti qajnë në dhembje përgjithmonë. Unë atëherë jetoja pranë Portës dhe më kujtohet mirë ajo natë. Isha ulur në dyshe-menë e dhomës time dhe po lozja. Në një çast u dëgjua krisma e madhe e shpërthimit dhe britmat. E hutuar dëgjoja të qarat dhe ulurimat e njerëzve që pa ndërprerë i thirrnin disa emra. Nuk pash asgjë, sepse roletnat e gjelbërta mbulonin dritaret e mia. Prindërit e mi kishin dal jashtë dhe po e thirrnin motrën time, e cila ishte duke

shetitur diku me shoqet e saja. Më në fund u kthye në shtëpi. Kurrë nuk e kisha parë aq të frikësuar. Ishte ulur në kolltuk dhe po i mbante këmbet me duar që të mos shihet se sa janë duke u dridhur. Të gjithë e dinim se Darja nuk frikësohej shumë nga granatimet, dhe u befasuam shumë me reagimin e saj, kurse ajo vetëm përsëriste: “Po ju nuk dini se çka ndodhi... Po ju nuk dini se çka ndodhi...” Asgjë tjetër nuk mund të kuptonim nga ajo. Vetëm kur u kthyen mami dhe vëllau nga spitali, ku kishin dhuruar gjak për të lënduarit, u informuam se çka kishte ndodhur. Më parë motra kishte treguar se kishte qenë 50 metra larg Portës. Ka munguar pak që të vritet edhe motra ime. Pak ka munguar që të ma merrni dikën që më së shumti e dua në botë. Dhe për çka? Paj, e di unë për çka e keni. Për atë Serbinë tuaj të madhe. Dhe si mundem unë sot, pas gjithë asaj që ka ndodhur, të dalloj se a duhet të dua apo të urrej dike.

Thonë, e unë i besoj kësaj, se në jetë ndodh që ta takoni një person shkakut i të cilit e ndërroni mënyrën se si e shihni botën. Një person që të mëson se nuk mund t'i stereotipizosh njerëzit, sepse nuk jemi të gjithë të njëjtë. Unë këtë person e gjeta te Nenadi. E pata njohur në koxh, atje në Amerikë. Erdhi në orën e anglishtes dhe krejt rastësisht u ul pranë meje. Kur më tregoj emrin e pyeta nga është. Nenadi ishte nga Beogradi, serb, e unë vajzë nga Bosnja, gjysmë kroate, gjysmë Boshnjake. Dolëm bashkë. Isha e lumtur.

Më në fund dikush me të cilin kisha mundësi të flisja në gjuhën time dhe të qeshi me humorin tonë ballkanas të cilin amerikanët nuk e kuptojnë, ashtu sikur që as ne nuk e kuptojnë humorin e tyre. Ishte gjë e shkëlqyer që ti ndaj me dikend sekretet e mia, e në të njëjtën kohë të flas e të mos kuptohemi nga askush. Të flasim për këngëtarët, aktorët, filmat, qytetet që vetëm ne i dinim. Ndonëse më duhet të pranoj se më mundonte diçka. Nenadi më pëlqente. Por çka do të thonë të tjerët? Çka do të thonë prindërit e tij, babai i tij që ndoshta dikur në betejat babain tim e ka shikuar përmes nishanit të pushkës? Si do të reagojë nëna ime, që është dashur të kujdeset për tre fëmijët e saj, duke pritur me dro se a do kthehet babai im nga lufta gjallë? Si e kanë edukuar atë prindërit e tij? Çka i kanë thonë, kush është fajtor për luftën? Ne, ata, apo të gjithë ngapak? Si do të ndihesha unë nëse në luftë do ta kisha humbur ndonjë anëtarë të familjes, ose dikën tjetër që e kam të afërt? A do të pranoja në atë rast të dal me te dhe të bëhem e dashura e tij? Të gjitha këto pyetje më kanë munduar me ditë të tëra deri sa Nenadin nuk e njofta mirë, e pak më vonë edhe prindërit e tij. Ka pas debate të ashpra mes nesh se kush e ka filluar luftën, ne apo ata, por në fund të tyre vinim

në përfundim se nuk do të duhej të kacafyteshim për diçka që ne nuk kemi faj. Shpesh bënim shaka në llogari të kombësive tona. Nenadi kishte kujdes të mos e vishte majicën e gjelbërt sepse e dinte se do të bëja shumë “ngacmime” rreth kësaj. Pas këtyre situatave gjithnjë ia plasnim gazit të hareshëm. Prindërve të tij u pëlqeva shumë, e edhe unë i doja ata, sidomos nënën e tij e cila më thoshte shpesh: “Dijanë, bijë, eja sot në drekë të ngihesh me ushqimin tonë, e jo me atë amerikan”. Nënës time i tregova për Nenadin dhe mua. Ajo më tha po, nëse jam unë e lumtur edhe ajo do të jetë, dhe shtoi se ajo beson në mua dhe në vendimet e mia.

U ktheva në Tuzëll dhe studioj këtu. Nenadi studion në Sacramento ku më pret për çdo verë. Pa marrë parasysh se çfarë e ardhme na pret, shumë kam mësuar nga ai. Kam mësuar se nuk janë të gjithë njerëzit të njejtë, dhe nëse disa janë të këqinj, kjo nuk do të thotë se të gjithë janë të tillë. Sot, pesëmbëdhjetë vjet pas përfundimit të luftës, kur shikoj prapa dhe kujtoj vitet e luftës më ngjallet frika. Frika nga lufta që na ndodhi, duke na lënë pa shumë gjëra, shumë vetave ua mori edhe jetën; frika nga lufta e cila të gjithëve na kishte ulur tej mase çmimin e jetës. Kam frikë se një gjë e tillë mund të përsëristët dhe andaj lutem, dua dhe mendoj se e meritoj paqen dhe dashurinë dhe jo luftën dhe urrejtjen.

VËLLAZËRIM BASHKIMI

Më kujtohet saktësisht dita kur jam bërë i vetëdijeshëm se në RFSJ, dhe rrjedhimisht edhe në Bosnje dhe Hercegovinë, që ka qenë dhe ka mbetur një Jugosllavi e vogël, jetojnë kombet e ndryshme (edhe kombësitë, çkado që nënkupton kjo): viti ishte '80 e kusur, mbahej gara rajonale "Shtigjeve të Revolucionit të Titos", unë isha nxënës i klasës së katërt të fillores, një anëtar krenar i ekipit të shkollës "Jusuf Jakupoviq". Hëm, kjo krenari i takonte para së gjithash babait tim, pastaj shkollës, pastaj mësueses. Unë vetëm e dija që nuk kam obligim të rri në të gjitha orët e mësimit pasi që po përgatitesha për garën. Thelbësore ishte se nuk më mungonte motivacioni. Testin me shkrim e pata kaluar, në skenë ishim ulur 4 a 5 garues, salla ishte e mbushur me publikë, dhe njëri nga anëtarët e komisionit ma bëri pyetjen: "Cilët popujt jetojnë në Bosnje dhe Hercegovinë?" Deri në atë çast unë i pata numëruar dhe përshkruar të gjitha ofensivat e gjermanëve, përbërjen e njësive, taktikën, strategjinë, momentet kyçe të betejave kryesore partizane ("Nuk guxojmë assesi t'i lëmë të plagosurit!"), të gjitha detalet zbavitëse dhe edukative nga fëmijëria e shokut Tito, e pata recituar pemendësh "Librin mbi Titon" të France Bevkut, tregova edhe për seancat e AVNOJ-it dhe Lëvizjes të të Painkuadruarëve, por vetëm te kjo pyetja e fundit ngeca – çfarë popujsh se?!

Në botën time, që përbëhej nga ajo që e kisha mësuar në shtëpia, në bibliotekën e shkollës dhe nga "Programi shkollor" në TV, popujt nuk përmendeshin, e nëse po, kjo bëhej disi në mënyrë të pahetueshme. Nëna ime (me një "N" të madhe dhe një "a"), besimtare myslimane (e para luftës, të këtillë janë të rrallë), që si vajzë i kishte përcjellur tre vëllezërit e saj në partizane, dhe ata nuk janë kthyer më, për marrëdhëniet mes njerëzve (e mbase edhe ndërmjet popujve), kishte vetëm një reçetë lakonike: "Kur mos këqyr se çka është dikush, por çfarë është". Kjo thënie, si dhe një tjetër: "Krejt çka hudh kundër rrjedhës së lumit, ma vonë ta kthen prapa rrjedha e ujit", kanë qenë të mjaftueshme që unë edhe para betimit të parë solemn, i cili u shkel saora, të bëhem i shembullori P.I.O.N.I.E.R (Punëtor, Ideator, Optimist, i Ndershëm, Ithtar, Energjik, Revolucionar). Nëna popujt nuk i përmendte me emër, kurse nazistët, çetnikët, ustashët dhe partizanët biles shumë shpesh. Të parët zakonisht i

quante me një eufemizëm të përbashkët – “bandat”, e për ata të fundit, partizanët, emër më të bukur nuk kishte, e as që u duhej.

Deri sa të gjitha këto që u përmendën procesori im njëbërthamor i sillte në diskutim të fortë dhe të paplotësuar (ishte pa “particione” kombëtare), duke kërkuar përgjigjen e mundshme në pyetjen e shtruar, një anëtar tjetër i komisionit, me gjasa nga dëshira që të më dalë në ndihmë, i komplikoi edhe më shumë gjërat me pyetjen shtesë: “Po ti, çka je?” Si ore, “Çka jam”? jam: Pionier? Nxënës?! I nënës!?!

Komisioni vazhdoi t’i pyes garuesit tjerë, duke më lënë mua të skuqur në fytyrë, të hutuar dhe të turpëruar, që ta gjej përgjigjen, të cilën as deri në ditën e sotme nuk e kam gjetur. Tek dalja me priste fytyra e lumtur dhe krenare (më krenarja?) e babait dhe buzëqeshjet përçmuese të garuesve tjerë dhe të prindërve të tyre. Kështu përfunduan “shtigjet e revolucionit” të mia, dhe filloi udha ime revolucionare. Vitin tjetër hyra në pubertet të hershëm, kështu që në garën shkollore interne, preliminare, kastile jepja përgjigje të gabuara (Q: *Çka ka thënë Tito-ja në çastet vendimtare të Betejës së Neretvës?* A: *“Hej ushtarët aviatorë, ju jeni krahët prej çeliku të Armatës sonë”*), dhe kjo rezultoi me qortimin e drejtorit dhe u ndëshkova me parapërgjashtim.

Sot filozofët dhe njerëzit e shkencës mund ta zbulojnë lehtë se çka ka qenë e gabushme në sintagmën “Vëllazërim-Bashkim”. Në shikim të parë, mund të konkludohet me komoditet se kemi të bëjmë me një parullë fashiste. Përmenden vetëm vëllazërit, motrat janë përjashtuar nga ekuacioni (nga kjo arsye në luftën e fundit, dhuna ndaj grave bëhej me parmendimin sepse kështu po shkatëroheshin të mirat materiale-gjenetike të armikut?); ndërkaq “bashkimi” aludon në hegjemoni dhe njëmendësi. Për ata që janë lindur dhe edukuar në Vëllazërim dhe Bashkim, kjo kur nuk vihej aspak në dyshim dhe barazohej me dashurinë ndaj njeriut (Vëllau është i dashur, cilëso feje të jetë). Për ata që nuk e kanë përjetuar, kjo ka qenë shprehje e cinizmit dhe dyfytërsisë më të madhe, një shteg përmes të cilit karrieristët arrinin në pozita dhe, çka është absurdi më i madh, në rastin e tyre mu kjo ndodhte, ata e bënë të tillë.

Bota e fëmijëve ka qenë bardh e zi. Partizanët dhe gjermanët, kaubojët dhe indianët, çunat e mirë de të këqinj, ndarjet kanë qenë shumë të qarta dhe a do të bëhesh i këtillë apo i atillë ka qenë çështje fati (më shpesh me metodën “tek-a-qiftë”). Sa më shumë që jemi në moshë, bota bëhet më e komplikuar, ngjyrat ngatërrohen, kështu që edhe kufijt mes të zezës dhe të bardhës fillojnë të zhduken. Alija Izetbegoviçi në një sulm të rallë të mençurisë, kishte deklaruar se Bosnja dhe Hercegovina, e shikuar nga lartë, i ngjanë pikturave të Jackson Pollock-ut. Kjo është e saktë në çdo aspekt për çka mund të bindet çdokush që ka fluturuar ditën mbi këtë tokë të pafatë. Nëse shikojmë me vëmendje lëmshin e veprës së Pollockut, aty mund t'i dallojmë lehtas ngjyrat. Dhe nëse shikojmë me vëmendje zymtësinë e jetës dhe të vendit tonë, po ashtu do t'i dallojmë lehtësisht pikat e zeza dhe të bardha.

Revizionistët e historisë dhe relativizuesit e fajit përpiqen të na bindin se në luftërat nuk ka të mirë dhe të këqij, se e vërteta nuk është një, dhe se e bardha dhe e zeza nuk ekzistojnë. Kjo nuk është e saktë. Është e saktë së në luftën e fundit, dhe pas saj, nuk kanë ekzistuar partizanët, të paktën jo në atë masë sa kanë qenë atëherë. Dhe se rrallë kush sot ka fytyrë dhe kredibilitet të dalë para popullit dhe të thotë “asnjë kriminel nuk është i imi, dhe të gjitha viktimat janë të miat”; e ata që do të mund të thoshin këtë, si për shembull Sërgjan Aleksiqi, me gjasa kanë vdekur. Kjo është ajo që na mungon, kjo është optika që duhet ta kemi për t'i parë ato pikat e bardha dhe të zeza.

Për këtë, të kthehem në fillim të këtij tregimi, sot e di se si do t'i përgjigjesha atij xhaxhai, i cili më kishte pyetur se “çka jam”. Do ti thosha: “Jam partizan”. Dhe do të shtoja: “I nënës”.

Babushka¹

Nuk e kam harruar janarin e vitit '92 dhe largimin e familjes time në Gjermani, ndonëse shpesh i bind njerëzit se nuk kam kujtime të tilla. Kujtimet e mia kurrë nuk përputheshin me pritjet për këtë që i kishin të afërmit e mi nga Bosnja.

Kam qenë gjashtë vjeç kur filloi lufta. Prindërit e mi dhe unë në atë kohë veçse ishim vendosur në Gjermani. Shtëpia jonë e re ishte një banesë njëdhomëshe, ndoshta pak më e madhe se dhoma ime në Bosnje. Përnjëherë e tërë familja qëndronte dhe flente në një hapësirë. Në të vërtetë, kjo edhe më tej ishte dhoma ime, sepse shumë kohë qëndroja aty në vetmi. Prindërit aty e bënë vetëm gjumin, sepse niseshin në punë herët në mëngjes, dhe ktheheshin vonë në mbramje. Ndonjëherë kisha frikën se nuk do të kthehen fare dhe unë do të mbetem vetëm mes të huajve. Nuk di cila nga mundësitë më çmendte më shumë. Pastaj mendoja për luftën atje në vendlindje. Më së shumti frikësohesha për nanën dhe gjyshin, si dhe për kusherirët me të cilët lozja në vendlindje. Për luftën dija tepër shumë nga filmat kështu që vetës ia përfytyroja me imazhe nga më të tmerrshmet. Kisha frikë se asnjërin prej tyre kurrë më nuk do ta shoh në jetën time.

E urreja luftën për arsye se nuk mund të ktheheshim në shtëpi dhe pse i kërcënonte më të dashurit e mi. I urreja prindërit që më linin vetëm. E urreja vendin ku jetoja, dhe më së shumti vetminë.

Këto gjashtë muajt e parë të qëndrimit në Frankfurt me të drejtë mund t'i quaj periudhë më të errët të fëmijërisë sime të hershme. Ka qenë kohë e frikës dhe pasigurisë.

Pas gjashtë muajve u patëm shpërngul në një qytet tjetër, në një lagje më të bukur dhe banesë më komode. Deri atëherë u pata mësuar me vetminë, dhe shumë shpejt nisa të shkoja në shkollë. Ditën e parë e kujtoj si në mjegull. Nga lotët nuk e shihja babain se si po largohet, duke më lënë nën kujdesin e mësueses dhe në një mjedis gjuhen e të cilit nuk e kuptoja. Besoj se jam përshtatur me lehtësi pas një kohe të shkurtër, sepse aty gjeta moshatarët që më mungonin. Shoqja ime më e mirë e atëhershme

¹ Kukulla ruse që quhet Babushka ose Matryoshka është prodhuar nga fundi i shekullit 19. në afërsi të Moskës. Këto kukulla laramane kanë edhe paraardhëse nga Japonia, dhe zakonisht prodhohen si familje (rreth 8 sosh vijnë së bashku), dhe mund të janë të dy gjinive.

ishte Jasmin, e bija e një turke dhe një gjermani. Ajo është pika më e ndritshme e asaj periudhe, por që pat përfunduar me një thirrje telefonike. Një ditë më pat thirrë nëna e një nxanëse të sapoardhur në klasën tonë, dhe më tha se e bija e saj Zhaklina ka dëshirë të flas me mua. E ndjeve vetën shumë të rëndësishme sepse po më ftonte me telefon një shoqe e klasës, e që për më shumë ishte gjermane. Por Zhaklina nga ana tjetër e telefonit filloj të bërtiste dhe të më qortonte. Më tha se jam lopë e paditur, dhe ma tërhoqi vërejtjen se Jasmin dhe ajo janë tani shoqet më të mira, dhe se ato nuk duan që të shoqërohen me rrefugjatët. Të nesërmën nuk kisha më shoqe më të mirë. Fillova në përgjithësi të turpërohem nga prejardhja ime, por edhe ta urrej Zhaklinën, sepse e kishte edhe nënën e saj si aleate.

Në një rast zonjës që punonte në dyqanin e bukëpjekësit u pata përgjigjur “po” në pyetjen se a jam turke. Jasminën e donin, e ajo ishte turke, andaj edhe unë doja që të më donin. Kur u ktheva në shtëpi nëna më rrahu për këtë gënjeshtëri. Unë vazhdova të kam turp.

Ndërmjet viteve '92 dhe '94 mësova se çka do të thotë të jesh i dëbuar dhe i padëshiruar. U rreshtova së bashku me rumunët, pakistanezët dhe indusët, sepse edhe ata si mua moshatarët gjermanë na llogarisnin si Ausländera. Ajo që na lidhte ishte shenja e të qenit Tjetri.

Për çdo dy vite unë ia bëja vetës një mburoje të re, më të fortë. Bëhesha më e fortë dhe më e pjekur pas çdo shpërnguljeje dhe kalimi në shkollë të reja (kjo përnjëme ndodhte çdo dy vjet në periudhën '92 - '98). Vazhdova të isha nënë dhe babë jo vetëm për vetën time, por edhe për bebën e tezës, për të cilën kujdesesha nganjëherë edhe tërë ditën që nga mosha ime nëntëvjeçare. Vazhdova të urreja babain dhe nënën sepse punonin pa ndërprerë dhe me obligimet e imponuara ma shkurtonin kohën e paraparë për lojë. Por, me kohë u pata mësuar me obligimet dhe përgjegjësitë.

Kur u ktheva në Bosnje në vitin '98 nuk më pranuan as “bashkëvendasit” e mi. Deri atëherë unë kisha rënë nën ndikim të uesternizimit, dhe më janë dashur disa vjet që të përshtatem sërish mënyrës ballkanase të jetës. Kam jetuar në vendet ku kam qenë e padëshiruar, ku është dashur të luftoja për njohje dhe afirmim. Kriza e identitetit, me të cilën luftoj prej kohësh rrjedh nga hendeku të e cilin jetoja, dhe fajit që ma kishin

imponuar kusherinjtë me të cilët lozja kur isha e vogël, për shkak të privilegjeve që kisha në raport me ta.

Sot ende merrem me rishqyrtimin e ekzistencës sime duke e krahasuar të kaluarën e afërt me gjendjen e tashme. Kur i vlerësoj realisht kujtimet subjektive, kuptoj se prindërit e mi kishin dhembje të njejtë kur më linin si fëmijë që të kujdesesha për veten, ashtu sikur që për mua ishte e dhembshme vetmia. Atë ditën e parë në shkollë edhe babai im kishte qarë, por këtë e kam kuptuar vetëm pasi që kishin kaluar 18 vjet. Rrethanat që krijojnë lufta na kishin detyruar të gjithë që të ridefinojmë para së gjithash raportet familjare, e pastaj edhe ato ndërnjerëzore. Të gjithëve u janë imponuar përgjegjësitë dhe obligimet, jo vetëm mua. Prindërit kishin ndërprerë “të kujesen”, andaj fëmijëria ime nuk ka qenë e pabrenga. Megjithatë, të gjithë jemi këtu. Mbijetuar.

Shpesh i shpalos ato mburoje që i kam veshur në periudhat e ndryshme, sepse dua t'i kujtoj veç e veç të gjitha ato vajza, çfarë kam qenë dikur – ti them vetës se kam qenë e guximshme dhe i kam përballuar me sukses brengat të imponuara nga rrethanat e luftës. Ua fala prindërve, sepse kishin zgjedhur që të punojnë edhe nga tri punë për ta ndihmuar familjen e gjërë në Bosnje, e cila ishte në luftë, madje duke paguar çmimin e neglizhimit të vajzës së tyre. Unë po zgjedh tani që nga kjo të nxjerr më të mirën.

500 fjalë të shtrydhura

Atje, në atë varr ndoshta janë e ndoshta nuk janë më eshtërat e tim atë. Krejt çka mund të prek aty është nishani nga mermeri, i cili mërdhinë si asnjë herë për shkak të këtyre temperaturave të ulta dimërore. A është babai im ky mermer, i zverdhur lehtas nga lagështia dhe koha? I them vetes se është më shumë si një e çarë në figurën e imagjinuar me dimensione kolosale, nën të cilën gjithnjë shkruante «Babai», por që prej njëzet e më shumë vitesh nuk u përgjigjet më thirrjeve me këtë emër. Ky është fillimi im. Ja, mu ky gjigand imagjinari i figurës së babait që nuk lëviz dhe nuk flet, por që si ajo gjë që e ka bërë të tillë – lufta – me ngulm bëhet pengesë që unë po përpiqem ta tejkaloj si një Sizif.

Një herë, diku në vetë fillimet e luftës, babai na pat sjell pak marmeladë «nga ushtria» në fund të një qeseje plastike; kështu e kujtoj atë çdo herë. Ngjitet shkallëve, më duket se mbanë uniformën ushtarake, dhe në dorë e ka marmeladën për motrën dhe mua. Nuk kishte më shumë se tri lugë, mendoj; e dredhëzave apo e kaqave? Nuk më kujtohe saktë shija. Unë isha pesë vjeç kur ai nuk ishte më. Më ka mbetur si amanet ku kujtimin mbi babain i cili me gjasa racionin e tij ditor prej tri lugësh marmelate, ua kishte sjell në sqep si një shpend për t'i ushqyer zogjtë e tij.

Si mund të mos çmendet njeriu? A ka diçka që më garanton maturinë time? Faktin numër një biografik e kam ikjen. Gjërat që i *dua* i përshkruaj në anglisht; të gjitha që më *shqetësojnë* ose që më ngjallin *neveri*, i përshkruaj në gjuhën time. Gjuha amtare për mua është gjuha e traumës. Dhe ik nga ajo. Ja, edhe tash po ik. Ta qifsha gjuhën jugosllave. Edhe këto fjali që i shkruaj si dromca. Mendime të shkëputura. Kujtime të gjysmëshprehura.

Por shkruaj sepse e di se jam i detyruar. Nëse unë nuk shkruaj, do të shkruan dikush që nuk i ka përvojat e mia, që nuk i përshtaten çizmet e fëmijërisë time dhe i cili do t'i fut me zor në ato shputa të tij të mëdha. Nëse shkruan, reziston. Madje edhe kur i reziston shkrimit. Para hyrjes së Luftës së Dytë Botërore Virginia Vulf, në romanin e saj të fundit, pat shkruar: «Kjo është barra me të cilën më ka ngarkuar e kaluara... ajo që duhet ta kujtojmë; e që do ta haronim...». Dhe vërtet, - do të mund të ikja në fund të botës, të rrehatohesha në disa realitete tjera, ti gjuaja shigjetat e mendjes në disa probleme të atjeshme, por nuk mund të ik nga kujtimet.

Jo që nuk mundohem, por nuk më shkon. Mbi ditët e shkollës fillore edhe më tej fluturojnë Boforsët. Në domatet e bashqes së fëmijërisë edhe më tej janë gjurmët e kalbura të copëzave të granatve të shpërthyera; mbi idenë e «ëmbëlsirave të gjyshes» edhe më tej pipeton rrjeti i marimangës nga mielli i misrit (të vetmin që kishim), pa sheqer dhe vaj. Në vend të gjelërave nga fotot e «Gatojsës boshnjake», që e ka vendin e caktuar në rafte, fëmijëria është e pllakosur me receta të «gurabie të luftës», të «karamelave të luftës», dhe gjërave tjera të luftës (përbërës kryesor i të gjithave: qumështi pluhur – nga rezervat amerikane të Luftës së Dytë Botërore; keksat «kantash» nga po këto rezerva; mielli i misrit; pekmez shtëpiak nga mollat si ëmbëlsues i vetëm – i pjekur ndër granata)...

Në vend të babait në tavolinë është gjithnjë vendi i zbrazët, ku bie hija e figurës gjigande që nuk flet asnjë gjuhë, sidomos jo gjuhët jugosllave. Dhe ky është dengu i barës time; që të kujtoj, mendoj dhe shënoj, përderisa vrasësit e fëmijërisë time shëtisin metropoleve të botës dhe hanë sushi duke u shoqëruar me ata që e kanë financuar krimin.